TRAINKOS SH.A.
TRAINKOS D.D.
TRAINKOS J.S.C.
Nr.No.Br. 2/11
Dt. 28.02.2019
Fushë Kosovë - Fushë Kosova - Kosovo Polje

trainkos
Hekurudhat e Kosovës

RAPORT VJETOR 2018

Vendimi: Nr. 2/11

Bordi i Drejtorëve i HK "Trainkos" Sh.a njëzëri miratoi Raportin Vjetor për vitin 2018 në mbledhjen Nr.42 të mbajtur më datë 28.02.2019

	Delegoi	Aprovoi
Emri Mbiemri:	**Gelor Shala** **Kryeshef Ekzekutiv**	**Sadik Kryeziu** **Kryesuesi i BD**
Nënshkrimi:		
Data:	**15.02.2019**	**28.02.2019**

trainkos

Hekurudhat e Kosovës

RAPORT VJETOR 2018



PËRMBAJTJA

I.	**HYRJE**	3
II.	**RAPORT I KRYESUESIT TË BORDIT TË DREJTORËVE**	4
II. 1.	Aktivitetet dhe performanca e ndërmarrjes	4
II. 2.	Informacione lidhur me kapitalin dhe dividenten	7
II. 3.	Të dhënat për drejtorët jo-ekzekutivë	8
II. 4.	Komitetet e Bordit të Drejtorëve të Trainkos Sh.a	9
III.	**FJALA E KRYESHEFIT EKZEKUTIV**	10
III. 1.	Ngjarjet kryesore të vitit	12
IV.	**PASQYRA E PERFORMANCËS OPERATIVE**	13
IV. 1.	Transporti i Mallrave	13
IV. 2.	Transporti i Udhëtarëve	16
IV. 3.	Sektori i Mirëmbajtjës	10
V.	**PASQYRA E PERFORMANCËS FINANCIARE DHE REZULTATET**	21
V. 1.	Gjendja financiare	21
	Tabela 1. Të hyrat dhe Shpenzimet Operative	22
V. 2.	Gjendja në para të gatshme – Raporti sipas Bankës (31.12.2018)	25
V. 3.	Bilanci i gjendjes	25
VI.	**PROJEKTET KAPITALE**	26
VII.	**PRESPEKTIVA PËR VITIN E ARDHSHËM**	27
VII. 1.	Sfidat dhe rreziqet e të ardhmes së korporatës	28
VIII	**STRUKTURA ORGANIZATIVE E TRAINKOS SH.A**	29
IX	**KONTESTET GJYQËSORE**	31
IX. 1.	Rreziqet nga kontestet gjygjësore për vitin 2019	31
X.	**TRANSAKSIONET E REALIZUARA**	32
XI.	**PËRFUNDIM**	33

I. ANEKS RAPORTI

- Raport lidhur me sponsorimet dhe donacionet
- Raport Vjetor i Zyrës së Auditimit të Brendshëm për vitin 2018
- Raporti i vetëvlerësimit të Bordit të Drejtorëve

I. HYRJE

Gjatë vitit 2018, Trainkos Sh.A kishte një vështirësi në realizimin e planit operativ dhe financiar. Ndërmarrja edhe gjatë këtij viti është ballafaquar me sfida të shumta dhe të ndryshme, ashtu sikurse viteve të kaluara. Përkundër faktit që tani është arritur marrëveshja me Ministrinë e Infrastrukturës për Obligimet e Shërbimeve ndaj Publikut për një periudhë pesëvjeçare, shpenzimet në transportin e udhëtarëve ende nuk janë mbuluar të gjitha. Gjithashtu, edhe ndryshimet e ndodhura në treg, konkurrenca nga operatorët privat hekurudhor e rrugor dhe ndërprerja e transportit për një periudhë pesëmujore nga klienti kryesor NewCo Ferronikeli kanë ndikuar që viti 2018 të jetë me rezultate jo shumë të kënaqshme. Përkundër këtyre sfidave, falë angazhimit të palodhshëm të tërë ekipit të HK - Trainkos Sh. A. është arritur që ndërmarrja të ruaj likuiditetin e saj.

Në vijim të këtij raporti do të përfshihen aktivitetet dhe ngjarjet më të rëndësishme të ndërmarrjes të cilat janë zhvilluar gjatë vitit 2018. Raporti është ndërtuar sipas kërkesave ligjore dhe udhëzimeve të Aksionarit si dhe përmban edhe disa pjesë tjera të rëndësishme që e pasurojnë edhe më shumë këtë raport.

Në fillim të raportit është prezantuar fjala e kryesuesit të Bordit të Drejtorëve, ku është theksuar performanca e kompanisë bashkë me disa prej aktiviteteve të saj. Raporti i Kryesuesit ofron informacione edhe në lidhje me kapitalin e kompanisë, politikat që ndikojnë në zhvillimin e biznesit si dhe të dhënat tjera për strukturën dhe angazhimet e Bordit.

Në vazhdim pasqyrohet raporti i Kryeshefit Ekzekutiv, duke ofruar të dhëna për ngjarjet kryesore për periudhën raportuese, të dhënat për performancën operative e financiare dhe angazhimin në drejtim të realizimit të Planit të Biznesit. Në këtë pjesë raporti ofron të dhëna të detajuara për shpenzimet, investimet kapitale të kompanisë dhe gjithashtu një elaborim të perspektivës bashkë me rreziqet e mundshme ndikuese. Po ashtu brenda raportit është paraqitur edhe skema organizative e ndërmarrjes, ndryshimet e ndodhura gjatë kësaj periudhe si dhe një pjesë e raportit i është kushtuar çështjeve të ndryshme të lidhura me kontestet gjyqësore. Për të qenë raporti sa më i qartë dhe i kompletuar, brenda tij janë përfshirë edhe grafikone, tabela statistikore dhe skema tjera me sqarime të nevojshme.

Raporti Vjetor 2018 i HK - Trainkos Sh.A. ka të bashkëngjitur edhe shtojcën apo Aneksin 1, i cili përmban të dhëna tjera shtesë të cilat mbesin për përdorim të Aksionarit. Në këtë pjesë janë përfshirë raporti lidhur me sponsorimet dhe donacionet, Raport Vjetor i Zyrës së Auditimit të Brendshëm për vitin 2018 dhe Raporti i Vetëvlerësimit të Bordit të Drejtorëve.

II. RAPORT I KRYESUESIT TË BORDIT TË DREJTORËVE

Të nderuar aksionarë,

Nga mesi i muajit shtator 2015 është emëruar Bordi i Drejtorëve të Hekurudhave të Kosovës - Trainkos Sh.A. Që nga kjo periudhë Bordi është angazhuar me përkushtim të lartë që ndërmarrja të ketë kontinuitet të punëve në arritjen e rezultateve në raport me objektivat e planifikuara, angazhim i cili ka vazhduar edhe gjatë viteve në vijim dhe gjatë vitit 2018.

Përmbushja e obligimeve dhe përgjegjësive ligjore ka qenë fokusi kryesor i Bordit. Bazuar në Ligjin Nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike dhe Ligjin për Shoqëritë Tregtare (Nr. 02/L-123), Bordi i Drejtorëve i Trainkos Sh.A, në emër të aksionarit ka ushtruar kompetencat e veta në përmbushjen e detyrave dhe obligimeve që dalin edhe nga ligjet tjera të aplikueshme për NP-të. Hartimi i politikave dhe dokumenteve tjera strategjike për kompaninë si dhe mbikëqyrja e vazhdueshme në zbatimin e tyre ka qenë fokusi kryesor i BD për një qeverisje korporative të ndërmarrjes.

Në saje të angazhimi të të gjithë drejtorëve të bordit nuk kanë munguar as sukseset në përmbushjen e obligimeve. Po ashtu edhe angazhimi i stafit menaxhues është për t'u vlerësuar.

Në vijim, në këtë raport-vështrim do të paraqesim të dhënat mbi aktivitetet, performancën e ndërmarrjes dhe të dhëna tjera të rëndësishme për vitin 2018.

II. 1. AKTIVITETET DHE PERFORMANCA E NDËRMARRJES

Në këtë pjesë të raportit do të pasqyrohen të dhënat për performancën e ndërmarrjes si dhe sfidat më të cilat jemi ballafaquar. Aktivitetet kryesore të ndërmarrjes kanë qenë në realizimin e objektivave të planifikuara për vitin 2018 si dhe angazhimi në tejkalimin e pengesave dhe vështirësive tjera.

Një ndër sfidat me të cilat u ballafaquam qysh në fillim të punës sonë, ishte mungesa e mjeteve për të mbuluar shpenzimet në transportin e udhëtarëve, sfidë e cila është duke vazhduar edhe tani përkundër ndryshimeve që kanë ndodhur. Në fillim të vitit 2018 është arritur marrëveshja për OSHP për një periudhë pesëvjeçare, mirëpo edhe pse kjo është një e arritur, mjetet e ndara nga Buxheti i Kosovës nuk janë të mjaftueshme për mbulimin e të gjitha shpenzimeve edhe pse tani kemi më pak trena në operim se sa në vitet paraprake.

Përderisa mbulimi i shpenzimeve të transportit të udhëtarëve është definuar qartë me Ligjin për Hekurudhat e Kosovës, kjo çështje ende nuk ka marr zgjidhjen e duhur nga institucionet përkatëse. Çështja e mbulimit të shpenzimeve të transportit të udhëtarëve është njëri prej problemeve që e ka përcjell ndërmarrjen qysh nga ndarja e Hekurudhave të Kosovës dhe si e tillë ende nuk është trajtuar sipas kërkesave ligjore. Gjithashtu, edhe rëniet në transportin e mallrave kohëve të fundit kanë qenë shumë të theksuara të cilat kanë bërë që ndërmarrja të jetë në një situatë tejet të vështirë. Këto çështje do të jenë sfiduese edhe në të ardhmen dhe paraqesin shkaqet më ndikuese në performancën dhe zhvillimin e ndërmarrjes.

Kompletimi me dokumente strategjike e ligjore, mbi bazën e të cilave zhvillohet aktiviteti i ndërmarrjes të Hekurudhave të Kosovës - Trainkos Sh.A gjithashtu ka qenë fokus i Bordit dhe menaxhmentit që t'i përmbushim këto obligime.

- **Aktivitetet kryesore të ndërmarra gjatë vitit 2018**

Përkushtimi kryesor i Bordit të Drejtorëve gjatë vitit 2018 ka qenë arritja e caqeve të përcaktuara në Planin e Biznesit për këtë vit. Për shkak të gjendjes në ndërmarrje, mos mbulimit të shpenzimeve në transportin e udhëtarëve ndërmarrja ka bërë rishikimin e Planit të Biznesit për vitin 2018.

Përkundër përpjekjeve dhe angazhimit të përbashkët të Bordit dhe të stafit të kompanisë, objektivat e përcaktuara nuk është të arritur të përmbushën gjatë këtij viti për arsyet që theksuam më sipër. Besojmë që viti 2019 do të jetë më realizim më të mirë dhe presim që çështja e mbulimit të shpenzimeve në transport të udhëtarëve të marrë zgjidhjen e duhur në rastin e rishikimeve buxhetore.

Hartimi i politikave të kompanisë ka vazhduar edhe gjatë vitit 2018. Janë nxjerrë një serë rregulloresh të cilat definojnë shumë procedura e çështje të brendshme të organizimit të punëve si dhe të transportit.

- **Pasqyra e performancës operative dhe financiare në krahasim me vitin paraprak dhe planin e vitit aktual**

Gjatë vitit 2018 Hekurudhat e Kosovës - Trainkos Sh.A. kanë pasur një rezultat jo shumë të kënaqshëm operativ. Në aspektin operativ, në transportin e udhëtarëve kemi mbajtur në operim të gjithë trenat e udhëtarëve të planifikuar në Marrëveshjen për OSHP dhe gjithashtu kemi pasur për disa ditë në operim edhe trenat e jashtëzakonshëm në Linjën Ferizaj – Hani i Elezit dhe anasjelltas për shkak të ndërprerjes së transportit rrugor në këtë relacion. Trenat e jashtëzakonshëm janë lëshuar në qarkullim me porosi nga ana e Ministrisë së Infrastrukturës dhe në bazë të marrëveshjes midis nesh e cila është si Aneks i marrëveshjes bazë për OSHP.
Në transportin e mallrave realizimi i planifikuar është arritur në masë jo shumë të kënaqshme dhe gjithashtu krahasuar me vitin paraprak realizimi ka qenë më i dobët.

Sa i përket realizimit financiar në transportin e mallrave gjithashtu niveli i arritur nuk ka qenë i kënaqshëm krahasuar me planifikimin dhe gjithashtu edhe realizimi krahasuar me vitin paraprak.
Po ashtu, edhe në transportin e udhëtarëve realizimi financiar nuk është arritur në shkallën e planifikuar, por edhe në krahasim më vitin paraprak realizimi ka qenë më i ulët.

- **Transporti i Mallrave**

Performanca operative në transportin e mallrave, sikurse është e pasqyruar edhe në pjesën tabelore por edhe përshkruese të këtij raporti, është se planifikimi i mallrave të transportuara është realizuar në shkallën prej 82% neto tonë mallra të, apo për 28 % më pak se realizimi gjatë vitit 2017.

Performanca financiare nga transporti i mallrave është arritur në shkallën prej 82 % të shumës së planifikuar, ndërsa krahasuar me vitin paraprak është për 30 % më pak.

- **Transporti i Udhëtarëve**

Performanca operative në numrin e udhëtarëve është për - 24.4 % më pak në krahasim me vitin paraprak si dhe për - 34.2 % më pak se sa planifikimi për vitin 2018.

Sa i përket realizimit financiar në transportin e udhëtarëve nga shitja e biletave, përkatësisht të hyrat nga kjo kategori kanë qenë - 34.9 % krahasuar me planifikimin 2018, ndërsa krahasuar me vitin 2017 të hyrat kanë qenë prej - 21 % më pak.

- **Ngjarjet të cilat ndikojnë në të ardhmen e ndërmarrjes**

Një ndër sfidat kryesore për kompaninë Hekurudhat e Kosovës - Trainkos Sh. A. mbetet modernizimi i parkut të mjeteve lëvizëse duke pasur parasysh numrin e vogël të këtyre mjeteve që kemi në dispozicion por edhe vjetërsinë e tyre të cilat përveç shpenzimeve të larta për mirëmbajtje kanë edhe shpenzime tjera operuese të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në rritjen e kostos se përgjithshme.

Vlen të theksohet se kjo gjendje e mjeteve lëvizëse që kemi në parkun tonë është si rezultat i buxhetit të vogël të ndarë nga ana Qeverisë së Republikës së Kosovës për Hekurudhat e Kosovës - Trainkos Sh.A. Mjetet e ndara për projektet kapitale në vitin 2018 nuk është arritur që të shfrytëzohen në plotni pasi që në publikimet për furnizim me tren motorik nuk kemi pasur asnjë ofertues pasi që buxheti ka qenë tejet i vogël.
Fillimi i investimeve në modernizimin e rrjetit hekurudhor është shumë më rëndësi për zhvillimin hekurudhor, por nga kjo kërkohet që investimet të shtohen edhe në modernizimin e mjeteve lëvizëse të HK-Trainkos Sh.A

Po ashtu, sfidë e vazhdueshme mbetet përpilimi dhe hartimi i politikave strategjike për

zhvillim të kompanisë. Në këtë kontekst, BD është i përkushtuar të ndërmarrë nismat që janë në përgjegjësi të tij, që projekteve paraprake t'u japë shtytje për realizim.

Gjatë vitit 2019, presim që çështja e mbulimit të shpenzimeve në transportin e udhëtarëve të zgjidhet ashtu siç parashihet me Ligjin për Hekurudhat e Kosovës dhe të kemi mbulim të plotë të këtyre shpenzimeve.

Gjithashtu vlen të theksohet se shërbimet e veçanta që ofrojmë kërkojnë edhe përgatitje profesionale të veçantë. Andaj, fokus i angazhimeve tona do të jetë përgatitja e kuadrove, qoftë përmes ndonjë iniciative për hapje të drejtimeve shkollore përkatëse në Kosovë, apo edhe përmes trajnimit dhe certifikimit nga institucione e organizata ndërkombëtare relevante.

- **Të priturat për vitin e ardhshëm**

Një prej synimeve tona, padyshim që është planifikimi i investimeve në modernizimin e mjeteve lëvizëse dhe, pse jo, në blerjen e mjeteve të reja. Për këtë jemi të vetëdijshëm se është një mision i vështirë, por me ndihmën e aksionarit dhe me ato pak mundësi tona financiare, pa lënë anash edhe mundësinë për gjetjen e donatorëve apo formave tjera për investim shpresojmë se do t'ia dalim mbanë. Për këtë qëllim kemi realizuar shumë takime dhe jemi në negociata me disa mekanizma ndërkombëtarë për të siguruar donacione apo forma tjera të përshtatshme dhe të leverdishme për investime në modernizim dhe avancim teknologjik.

Për të përcaktuar nevojat për investime, kompania është e angazhuar në hartimin e një plani afatmesëm për investime.

Përkundër sfidave me të cilat ballafaqohemi, vitin e ardhshëm presim arritjen e objektivave të parapara në planin e biznesit për vitin 2019 siç është rritja e transportit të mallrave vendore dhe ndërkombëtare si dhe rritje në transportin e udhëtarëve.

II. 2. INFORMACIONE LIDHUR ME KAPITALIN DHE DIVIDENTEN

Përkundër ngecjeve dhe vështirësive që ka pasur në realizimin e projekteve në të kaluarën, gjatë vitit 2018 ndërmarrja ka zhvilluar procedurat për të gjitha projektet kapitale të planifikuara, mirëpo nuk është arritur që të kemi asnjë ofertues lidhur me furnizimet me tren motorik.

Mjetet për projektet kapitale në shumën prej 800,000.00 €, të ndara nga Buxheti i Republikës së Kosovës për vitin 2018 janë shfrytëzuar në shumën prej 260,354.00€.

Një e dhënë tjetër që duhet theksuar është edhe fakti se Hekurudhat e Kosovës - Trainkos Sh.A. gjatë këtij viti nuk kanë nënshkruar asnjë marrëveshje kredituese gjë e cila na bën të ndihemi mirë pasi që ndërmarrjen nuk e kemi futur në asnjë borxh që do të ndikonte negativisht në zhvillimet e mëtejme.

Mirëpo, është më rëndësi të theksohet edhe fakti tjetër se humbjet financiare të ndodhura nga vitit e mëparshme janë të larta për shkak të mos mbulimit në tërësi të shpenzimeve në transportin e udhëtarëve nga ana e ministrisë përkatëse dhe ndërmarrja është në obligime të larta financiare për pagesat e qasjes në binarë ndaj menaxherit të infrastrukturës - Infrakos Sh. A.

Për shkak të kësaj gjendje, ndërmarrja nuk ka arritur atë nivel të realizimit që do të mundësonte shpërndarjen e **dividentës**, (fitimit) ashtu siç është e paraparë me aktet juridike të cilat rregullojnë këtë çështje.

II. 3. TË DHËNAT PËR DREJTORËT JO-EKZEKUTIVË

Bordi i Drejtorëve i Hekurudhave të Kosovës-Trainkos Sh.A është emëruar me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës me nr. 06/49,të datës 16.09.2015. Në bazë të këtij vendimi si dhe të Ligjit për Ndërmarrjet Publike, Bordi i Drejtorëve në emër të Aksionarit ka ushtruar kompetencat e veta në përmbushjen e detyrave dhe obligimeve që dalin nga ligjet tjera të aplikueshme për NP-të.

Gjatë vitit 2018, Bordi i Drejtorëve punën e vet e ka zhvilluar në mungesë të dy drejtorëve pasi që gjatë vitit 2017 njëri prej anëtarëve të Bordit kishte dhënë dorëheqje, i cili ka qenë njëkohësisht edhe Kryesues i Komisionit të Auditimit, dhe tjetri ka lënë detyrën e tij në bazë të vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 15/05 të datës 29.09.2017. Nga përbërja e mbetur në Bord të Drejtorëve, në fillim të vitit, përkatësisht më 11.01.2018, me vendimin nr. 01/29 të Ministrit të MZHE-së janë bërë plotësim ndryshimet në Komisionin e Auditimit.

Gjatë vitit 2018 Bordi i Drejtorëve i Hekurudhave të Kosovës-Trainkos Sh.A ka mbajtur gjithsej 11 mbledhje duke llogaritur edhe Mbledhjen e Përgjithshme Vjetore me Aksionarin. Po ashtu edhe konsultat dhe kontaktet tjera midis drejtorëve të Bordit dhe menaxhmentit të kompanisë kanë qenë të shpeshta. Në muajin shtator 2018, pas dilemave të shfaqura rreth vazhdimit të mandatit të Bordit nuk është arritur që mbledhja për këtë muaj të mbahet.

Në pjesën në vijim do të pasqyrohen të dhënat e vendosura në tabela për strukturën e Bordit të Drejtorëve, Komisionin e Auditimit dhe të komiteteve të cilat kanë funksionuar gjatë vitit 2018.

Të dhënat për drejtorët jo-ekzekutivë:

PËRBËRJA E BORDIT TË DREJTORËVE TË HK TRAINKOS Sh.A			
Nr.	**Emri dhe Mbiemri**	**Pozita**	**Pjesëmarrja në mbledhje**
1	Sadik Kryeziu	Kryesues	11
2	Naim Gashi	Anëtar	11
3	Bastri Sallahu	Anëtar	11
4	Mustafa Mustafa	Anëtar	11
5	Gelor Shala	Kryeshef Ekzekutiv	10
6	Afrim Kuleta	Sekretar	11

II. 4. KOMITETET E BORDIT TË DREJTORËVE TË HK – TRAINKOS Sh. a.

Me qëllim të përmbushjes së obligimeve ligjore dhe arritjes së performancës së kompanisë, punën e Bordit të Drejtorëve e kanë ndihmuar edhe komitetet e krijuara nga vetë Bordi si dhe Komisioni i Auditimit i cili është formuar nga Aksionari.

Kontributi i komiteteve ka qenë tejet i rëndësishëm në definimin e shumë çështjeve dhe lehtësimin e punëve të Bordit. Në pjesën në vijim të këtij raporti do të paraqesim të dhënat për përbërjen e këtyre komiteteve, kohën e funksionimit si dhe numrin e takimeve të mbajtura gjatë vitit 2018.

Të dhënat për Komisionin e Auditimit dhe komitetet e Bordit:

Komiteti	Emri dhe Mbiemri		Pozita	Pjesëmarrja në mbledhje
KOMISIONI I AUDITIMIT	1	Naim Gashi	Kryesues nga data 11.01.2018	15
	2	Mustafa Mustafa	Anëtar	15
	3	Bastri Sallahu	Anëtar nga data 11.01.2018	15

Komiteti	Emri dhe Mbiemri		Pozita	Pjesëmarrja në mbledhje
KOMITETI PËR HULUMTIME DHE TEKNOLOGJI 31.08.2017 - Aktiv	1	Naim Gashi	Kryesues	2
	2	Bastri Sallahu	Anëtar	2
	3	Gelor Shala	Anëtar	2
	4	Shiqeri Spahiu	Anëtar	2

Në emër të Bordit të Drejtorëve të Trainkos Sh.a
Sadik Kryeziu – Kryesues

III. FJALA E KRYESHEFIT EKZEKUTIV

Ndërmarrja HK-Trainkos Sh. A. arriti që vitin 2018 ta përmbyll me vështirësi të mëdha, kjo si rezultat i faktorëve që tanimë dihen siç është mosfunksionimi normal në transportin e mallrave si dhe mos mbulimi i shpenzimeve në transportin e udhëtarëve nga ana e Ministrisë së Infrastrukturës sipas ligjit 04/L-063. Përkundër faktit të ndërprerjes së 4 trenave shpenzimet në transportin e udhëtarëve vazhdojnë të mbeten të pambuluara në tërësi.

Pavarësisht angazhimit të vazhdueshëm të stafit ekzekutiv dhe drejtues të ndërmarrjes për zhvillimin e biznesit dhe përformancës në ndërmarrje, sfidat me të cilat po ballafaqohemi në të shumtën e rasteve vijnë si faktorë të jashtëm dhe kanë ndikuar negativisht në zhvillimin e ndërmarrjes.

Qasja vetëm në një portë doganore – linjë ndërkombëtare, ka limituar në masë të madhe mundësinë e rritjes së transportit ndërkombëtar të mallrave (export - import). Aktualisht transporti ndërkombëtar hekurudhor zhvillohet vetëm përmes Maqedonisë, kufiri në veri qëndron i mbyllur për arsye të ditura politike edhe pse në aspektin teknik linja hekurudhore është e operueshme, ky fakt ka hendikepuar në masë të madhe funksionimin normal në transportin e mallrave duke bërë që shumë klientë potencialë të orientojnë transportin duke zgjedhur alternativa tjera.

Tregu i transportit vendor të mallrave nuk ka qenë i kënaqshëm në pjesën më të madhe të vitit, si rrjedhojë e liberalizimit të tregut duke mos u respektuar rregullat dhe standardet e operimit në transportin hekurudhor. Është krijuar konkurrencë jolojale që ka ndikuar negativisht në përformancen e ndërmarrjes duke pas parasysh që ne si ndërmarrje jemi të obliguar dhe respektojmë të gjitha standardet për operim.

Vazhdojnë të mbetën sfidë fondet e pamjaftueshme për investime kapitale në modernizimin dhe rritjen e flotës operuese, mjetet me të cilat operojmë janë të vjetra dhe si rrjedhojë krijojnë edhe shpenzime të mëdha.

Sfidat e cekura më lart ndikojnë drejtpërsëdrejti në përformancën e biznesit të ndërmarrjes. Gjithsesi, duke u bazuar në këto rrethana, me investim të vazhdueshëm që ndikojnë në uljen e shpenzimeve, duke u përqendruar në zhvillim të vazhdueshëm të ofertës dhe përmirësim koherent të shërbimit dhe njëkohësisht duke e rritur efikasitetin e strukturës organizative, kemi arritur një përformancë biznesore të kënaqshme, siç do të paraqitet në mënyrë të detajuar në raport.

Puna dinamike në funksion të përshtatshmërisë të rregulloreve të brendshme me legjislacionin në fuqi ka vazhduar edhe gjatë vitit 2018, po ashtu është trajtuar edhe aspekti i përshtatshmërisë me direktivat e Bashkimit Evropian dhe rregullave ndërkombëtare të operimeve në transportin hekurudhor.

Sa i përket realizimit të detyrave dhe respektimit të afateve ligjore të raportimit, ndërmarrja ka arritur që këto obligime t'i përmbush me sukses. Trainkos Sh.A me kohë ka hartuar Planin e Biznesit, është pajisur me licencat e nevojshme të operimit nga Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave (ARH) dhe në vazhdimësi ka raportuar tek aksionari mbi zhvillimet në kompani.

Kemi ndërtuar një ofertë të mirë për transport hekurudhor të mallrave dhe udhëtarëve, që ofron siguri, saktësi dhe çmime të volitshme dhe konkurruese të tregut. Në të njëjtën kohë jemi angazhuar maksimalisht që oferta jonë të arrijë te çdo klientë potencialë duke përdorur forma të avancuara të promovimit dhe shitjes duke shtuar kujdesin për konsumatorët e shërbimeve tona.

Një prej të arriturave është edhe realizimi me sukses i projektit kapital, renovimi i objektit në tërheqjen e trenave duke mundësuar një ambient shumë më të mirë për zhvillimin e aktiviteteve ditore për punëtoret e sektorëve të ndryshme.

Përkundër realizimit të këtyre projekteve, sfida kryesore për zhvillimin e gjithë biznesit të HK - Trainkos Sh. A. padyshim mbetet investimi në flotën e mjeteve lëvizëse (lokomotiva, vagonë dhe trena motorikë), ku duke pasur parasysh me mjetet që i kemi nga buxheti i Kosovës është shumë e vështirë modernizimi i tyre në masën e kërkuar për operim të rregullt.

Prandaj, duke pasur parasysh gjendjen aktuale të mjeteve lëvizëse, vjetërsinë e tyre dhe amortizimin, kërkohen investime emergjente.

Vlen të theksohet se kjo gjendje e mjeteve lëvizëse që kemi në parkun tonë është si rezultat i buxhetit të vogël të ndarë nga ana Qeverisë së Republikës së Kosovës për Hekurudhat e Kosovës - Trainkos Sh.A. Mjetet e ndara për projektet kapitale në vitin 2018 janë shfrytëzuar në disa projekte të rëndësishme për kompaninë, por megjithatë gjendja ende nuk është e kënaqshme sa i përket mjeteve lëvizëse.

Fillimi i investimeve në modernizimin e rrjetit hekurudhor është shumë më rëndësi për zhvillimin hekurudhor, por nga kjo kërkohet që investimet të shtohen edhe në modernizimin e mjeteve lëvizëse të HK-Trainkos Sh.A.

Jemi të përkushtuar dhe angazhuar maksimalisht për një zhvillim të gjithmbarshëm të kompanisë. Në kuadër të këtij përkushtimi do të kemi një plan afatmesëm strategjik për zhvillimin e kompanisë dhe ballafaqimin me rreziqet e natyrave të ndryshme të biznesit tonë. Do të vendosim objektiva të qarta mbi mundësinë e zgjerimit të pakos së shërbimeve që ofron kompania, për kompletimin e flotës së mjeteve lëvizëse, për zgjerimin e linjave të transportit dhe do të vazhdojmë me veprime konkrete në kuptim të rritjes së efikasitetit organizativ të kompanisë.

Kryeshef Ekzekutiv
Gelor Shala

III. 1. NGJARJET KRYESORE TË VITIT

Aktivitetet më të rëndësishme të cilat na kanë shoqëruar gjatë vitit 2018 janë të paraqitura si në vijim:

- Pajisja me certifikatën A dhe B të sigurisë nga Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave të Kosovës

- Aktiviteti biznesor me partnerët regjional gjatë vitit 2018 kufizohet në vazhdimin e iniciativave për bashkëpunim regjional dhe bilateral me shtetet e regjionit, të kufizuara kryesisht përmes shtetit të Maqedonisë nëse e kemi parasysh lidhjen e vetme ndërkombëtare hekurudhore.

- Nënshkrimi i Marrëveshjes për Shërbimet Publike (OSHP) për Transportin e Udhëtarëve për një periudhë afatgjate 5 vjeçare, 2018-2022.

- Renovimi i objekteve kryesore të tërheqjes së trenave, me këtë rast është rregulluar infrastruktura për punonjësit operativ, me kushte shumë optimale për punë.

- Nënshkrimi i kontratës për transportin vendor dhe ndërkombëtarë të xehes së nikelit me klientin kryesor NewCoFeronikeli për një periudhë 1.5 vjeçare.

IV. PASQYRA E PERFORMANCËS OPERATIVE E TRAINKOS SH. A.

Në këtë raport vjetor të punës do të paraqesim indikatorët fizik të performancës operative nga 1 janari deri më 31 dhjetor 2018, duke prezantuar realizimin e detyrave në krahasim me planifikimin që është bërë për të njëjtën periudhë raportuese me planin e Biznesit të vitit 2018, si dhe duke krahasuar atë me realizimin e vitit paraprak 2017. Natyrisht, do të komentojmë edhe ndryshimet që kanë ndodhur gjatë kësaj kohe.

IV. 1. DEPARTAMENTI I TRANSPORTI I MALLRAVE

Departamenti i transportit të mallrave është njëri prej sektorëve që ka rolin kryesor për ndërmarrjen. Rezultatet e arritura nga ky departament në vitin 2018 janë prezantuar në vijim, ku sasia e mallrave të transportuara është shprehur në ton:

Përshkrimi – Sasia e Transportuar	Janar – Dhjetor 2018 - Ton
Realizimi Neto Ton në 2017	**375,177.55**
Realizimi Neto Ton në 2018	**268,700.13**
Planifikimi Neto Ton në 2018	**327,500.00**
Realizim 2018 – Realizim 2017	**-106,477.42**
Realizim – Planifikim në 2018	**- 58,799.87**
Realizim 2018 – Realizim 2017 (%)	**71.61**
Realizim 2018 – Planifikim 2018 (%)	**82.04**

Tabela 4.1.1

Siç mund të shihet nga tabela 1.1 në këtë periudhë kohore kemi transportuar për rreth 28.39% më pak se sa në të njëjtën periudhë raportuese për vitin e kaluar dhe 17.96% më pak se sa sasia e planifikuar për këtë periudhë.

Transporti i mallrave me kontejnerë gjatë vitit 2018 ka qenë:

Përshkrimi – Numri i Transportuar i kontejnerëve	Janar – Dhjetor 2018
Kontejnerë të plotë - 2017	**48 copë**
Kontejnerë të plotë/zbrazët - 2018	**0 copë**

Tabela 4.1.2

Sasia e transportuar NT për vitin 2018




Figura 4.1.1

Siç mund të shihet nga figura 1.1 në aspektin operativ kemi arritur të realizojmë 82 % nga planifikimi për periudhën raportuese Janar- Dhjetor 2018 .

Të hyrat nga transporti i mallrave për periudhën raportuese :

Përshkrimi	Të hyrat në periudhën vjetore 2018 në €
Realizim shitje të hyra 2017	**842,834.98**
Realizim shitje të hyra 2018	**587,888.36**
Planifikimi 2018	**720,332.00**
Realizim 2018 - Realizim 2017	**-254,946.62**
Realizim – Planifikim 2018	**-132,443.64**
Realizim 2018 - Realizim 2017 në %	**69.75 %**
Realizim – Planifikim 2018	**81.61%**

Tabela 4.2.3

Siç mund të shihet nga tabela 1.3 neto/ton të shprehura në të hyra në vlerë Euro kemi arritur 81.61 % nga planifikimi për janar - dhjetor 2018. (Arsyeja e këtij rezultati është për shkak se NewCoferronikeli për pesë muaj nuk ka operuar fare gjatë vitit 2018)

Të hyrat në periudhën vjetore 2018




Figura 4.1.2

Ndërsa, nga reflektimi financiar i transportit të mallrave, siç mund të shihet nga shënimet më lart, të hyrat janë 45 % më shumë se sa vitin e kaluar për të njëjtën periudhë kohore raportuese dhe 82 % kemi realizuar planifikimin për vitin.

Të hyrat dhe shpenzimet nga transporti i mallrave

Përshkrimi	Të hyrat dhe shpenzimet €
Shitjet nga transporti i mallrave	**561,178.20**
Të ardhura tjera nga transporti i mallrave	**26,710.16**
Total shitjet	**587,888.36**
Shpenzimet direkte në transportin e mallrave	**670,662.47**
Shpenzimet indirekte në transportin e mallrave	**234,458.36**
Total shpenzimet	**905,120.83**
Fitimi/humbja operative	**- 317,232.47**
Fitimi/humbja në %	**- 35**

Tabela 4.1.4

Siç mund të shihet nga tabela 1.4 kemi një humbje prej 35% nga të hyrat dhe shpenzimet për periudhën Janar- Dhjetor 2018.

Në shitjet nga shërbimet e tjera të transportit të mallrave hyjnë**:**

Përshkrimi	Të hyrat dhe shpenzimet €
Shërbimet për transport të veçantë	**384.43**
Të ardhurat nga RIV dhe vendosja me vlerë	**23,560.91**
Shërbimet për shfrytëzim të mjeteve të transportit	**2,764.82**
Gjithsejtë:	**26,710.16**

Tabela 4.1.5

Të hyrat dhe shpenzimet gjatë vitit 2018




Figura 4.1.3

<u>Vërejtje:</u>

Shpenzimet indirekte janë përllogaritur në bazë të përqindjes së operimit të trenave përgjatë vitit 2018, duke marrë për bazë tren - kilometrat, ku ka rezultuar se trenat e mallrave kanë operuar rreth 19 % nga totali i tren-kilometrave që kanë operuar të gjithë trenat që kanë qenë për vitin 2018.

IV. 2. TRANSPORTI I UDHËTARËVE

Në fushën e sektorit të transportit të udhëtarëve gjatë kësaj periudhe kohore kemi pasur rezultate jo të kënaqshme krahasuar me vitin e kaluar. Heqja nga qarkullimi i trenave nr. 4201, 4200, 4102, 4103 ka reflektuar me rënie të numrit të udhëtarëve në krahasim me vitet e kaluara por edhe me planifikimin për vitin 2018.

Në tabelën më poshtë janë paraqitur krahasimet e përgjithshme të të dhënave të realizuara në periudhën janar – dhjetor 2018 me periudhën e njëjtë të vitit 2017. Në këtë tabelë shihet se kemi një rënie të numrit të udhëtarëve në këtë vit krahasuar me numrin e udhëtarëve për vitin e kaluar por edhe me planifikimin e vitit 2018.

Përshkrimi - Udhëtarë	Numri i Udhëtarëve 2018
Realizimi i numrit të udhëtarëve në 2017	**156,618**
Realizimi i numrit të udhëtarëve në 2018	**118,466**
Planifikimi i numrit të udhëtarëve në 2018	**180,000**
Dallimi: 2018 - 2017	**-38,152**
Dallimi: realizim - planifikimi 2018	**-61,534**
Dallimi: 2018 – 2017	**- 24.36 %**
Dallimi: realizim - planifikimi 2018	**- 34.19 %**

Tabela 4.2.1

Siç shihet nga shënimet e paraqitura më lart, sa i përket transportit të udhëtarëve për këtë periudhë kohore kemi pasur një numër më të vogël të udhëtarëve krahasuar me vitin e kaluar apo 24.36 % më pak dhe 34.19 % më pak kundrejt planifikimit. Vlen të theksohet, se nuk kemi mekanizëm për përcaktimin e saktë të numrit të udhëtarëve që frekuentojnë transportin hekurudhor duke pasur parasysh edhe kategoritë e liruara nga pagesat.

Në tabelën më poshtë është pasqyruar realizimi i transportit të udhëtarëve në vlera financiare:

Përshkrimi - Shitje e Biletave	Të hyrat 2018
Realizim shitje të hyra 2017	**123,382.14**
Realizim shitje të hyra 2018	**97,424.40**
Planifikimi 2018	**149,700**
Dallimi: realizim 2018 - realizim 2017	**-25,957.74**
Dallimi: realizim - planifikim 2018	**-52,275.60**
Dallimi: realizim 2018 - realizim 2017	**-21.04 %**
Dallimi: realizim - planifikim 2018	**-34.92 %**

Tabela 4.2.2

Vërejtje :

Mos realizimi për -34.92% sipas planifikimit ka rrjedhur nga mos respektimi (mos mbulimi) i marrëveshjes së OShP-së për vitin 2018 nga Ministria e Infrastrukturës, po ashtu të hyrat nga shitja e biletave nuk janë realizuar, për arsye se në 4 (katër) mujorin e parë kemi operuar vetëm me 4 (katër) trena, ndërsa planifikimi i shitjes së biletave pas nënshkrimit të marrëveshjes së OShP-së ka qenë operimi me 6(gjashtë) trena.

Ndërsa, reflektimi financiar i transportit të udhëtarëve, siç mund të shihet nga shënimet më lart në këtë periudhë kohore, është 21.04 % më pak sesa vitin e kaluar për të njëjtën periudhë dhe rreth 34.92 % më pak sesa planifikimi i paraparë për këtë periudhë.




Figura 4.2.1

Të hyrat dhe shpenzimet nga transporti i udhëtarëve

Përshkrimi - Të hyrat	Janar – Dhjetor 2018
Të hyrat nga transporti i udhëtarëve - OSHP	1,170,612.35 €
Të hyrat nga transporti i udhëtarëve - MZHE	500,000.00 €
Shitjet nga transporti i udhëtarëve	97,424.40 €
Të hyrat nga shërbimi i ID kartelave:	1,543.22 €
Të hyrat nga transporti i organizuar për udhëtarë	216.19 €
Kompensimi nga Aksidentet	28,080.00 €
Total të hyrat	1,797,876.16 €
Shpenzimet direkte në TU	998,420.47 €
Shpenzimet indirekte në TU	999,533.03 €
Total shpenzimet	1,997,953.50 €
Fitimi / humbja operative	-10.00 %

Tabela 4.2.3




Figura 4.2.2

Siç shihet nga tabela më lart, biznesi i transportit të udhëtarëve ka operuar me një humbje operative prej – **10.00 %** gjatë periudhës raportuese, duke llogaritur të hyrat nga: OSHP, MZHE-ja si dhe të hyrave nga shitja e biletave të udhëtarëve dhe transporteve të kontraktuara.

Vërejtje:
Shpenzimet indirekte janë përllogaritur në bazë të përqindjes së operimit të trenave për këtë periudhë njëvjeçare duke marrë për bazë tren-kilometrat, ku ka rezultuar se trenat e udhëtarëve kanë operuar rreth 81.00 % nga totali i tren-kilometrave që kanë operuar të gjithë trenat që ka qenë për vitin 2018.

IV. 3. SEKTORI I MIRËMBAJTJES

Në këtë pjesë të raportit do të paraqesim performancën nga sektori i mirëmbajtjes së mjeteve lëvizëse gjatë periudhës kohore të raportimit janar - dhjetor 2018.
Në vijim është pasqyruar produktiviteti në shfrytëzimin e fuqisë punëtore se sa dhe ku janë shfrytëzuar këto kapacitete si dhe është pasqyruar raporti në mes fuqisë punëtore në dispozicion dhe fuqisë punëtore të shfrytëzuar.

a) Mirëmbajtja e lokomotivave

Shërbimi i mirëmbajtjes se Lokomotivave gjatë vitit 2018 ka disponua me fuqi pune prej 17295 orë ku:

- 5870 orë, janë shfrytëzuar për riparim apo 34 % e fondit total të orëve;
- 2390 orë, janë shfrytëzuar për pune ndihmese dhe dytësore apo 14% e fondit total të orëve
- Produktiviteti i tërë ka qenë 48%

Intervenimet në mjetet tërheqëse gjatë vitit 2018 për secilin mjet tërheqës është dhëne në tabelën në vazhdim:

Mjete tërheqëse	2640 - 001	2640 - 002	2640 - 003	2640 - 004	2620 - 005	2640 - 006	2640 - 007	2640 - 008	2710 - 009	2640 - 010	2620 - 016	2760 - 001	2760 - 002	5800 - 001	5800 - 002
S					39		64	54	2	11	202	6		115	87
R					9		5	6	3	3	10	3	1	19	32
K 1					7		8	5	2	1	6	8		8	8
K 3					2		2	1			1	2		2	2
K 6					1		2	1			2	2		2	2

Tabela 4.3.1

S - Servisim,
R - Riparim,
K1 - Kontrollime njëmujor,
K3 - Kontrollime tremujor,
K6 - Kontrollime gjashtëmujor

b) Mirëmbajtja e trenave motorikë

Shërbimi i mirëmbajtjes për trenat motorikë gjatë vitit 2018 ka shpenzuar gjithsej 2196 orë. Në vazhdim është dhënë pasqyra numerike e servisimeve, kontrollimeve dhe riparimeve për mirëmbajtjen e trenave motorikë të realizuara në vitin 2018 krahasuar me vitin 2017:

	Lloji i riparimit/mirëmbajtjes	2018	2017	Ndryshimi
1	Servisime	200	214	-14
2	Riparime	52	49	3
3	Kontrollime K1	14	10	4
4	Kontrollime K3	4	1	3
5	Kontrollime K6	4	3	1
6	Gdhendja e rrotave	1	2	-1

Tabela 4.3.2

Mirëmbajtja e vagonëve për transportin e udhëtarëve dhe transportin e mallrave

Shërbimi i mirëmbajtjes së vagonëve gjatë vitit 2018 ka disponuar me fuqi pune prej 14073 orë ku:

- 4048 orë, janë shfrytëzua për riparim apo 29 % e fondit total të orëve
- 1847 orë, janë shfrytëzua për pune ndihmese dhe dytësore apo 13 % e fondit total të orëve
- produktiviteti i tërë ka qenë 42%

Në vazhdim është dhënë pasqyra numerike e testimeve të komponentëve, kontrollimeve dhe riparimeve për mirëmbajtjen e vagonëve të udhëtareve të realizuar në vitin 2018 krahasuar me vitin 2017.

	Lloji i riparimit/mirëmbajtjes	2018	2017	Ndryshimi
1	Kontrollime K1	113	68	45
2	Riparim në punëtori	34	13	21
3	Kontrollime në stacion	365	274	91
4	Gdhendje të rrotave	8	2	6
5	Testim i komponentave	2	15	-13

Tabela 4.3.3

Në vazhdim është dhënë pasqyra numerike e testimeve të komponentëve, kontrollimeve dhe riparimeve për mirëmbajtjen e vagonëve të mallrave të realizuara në vitin 2018 krahasuar me vitin 2017.

	Lloji i riparimit/mirëmbajtjes	2018	2017	Ndryshimi
1	Kontrollime K3	66	79	-13
2	Riparim në punëtori	13	13	0
3	Riparim në teren	2	3	-1
4	Gdhendje të rrotave	0	1	-1

Tabela 4.3.4

V. PASQYRA E PERFORMANCËS FINANCIARE DHE REZULTATET

1. Gjendja financiare,
2. Gjendja në para të gatshme - raporti sipas bankës (31.12.2018),
3. Bilanci i gjendjes,

V. 1. Gjendja financiare

Për periudhën raportuese janar – dhjetor 2018, gjendja e pozicioneve të të hyrave dhe shpenzimeve është siç vijon:

V. 1. 1. Të hyrat

Nga **Transporti i mallrave** kemi realizuar të hyrat prej 561,178.20 € për periudhën janar - dhjetor 2018. Totali i të hyrave të planifikuara për vitin 2018, është 720,332.00€ dhe nga kjo del se kemi realizuar 77.91% nga totali. Të hyrat nga transporti i mallrave eksport/import janë realizuar sipas kategorive që pasojnë: të hyrat nga importi i kemi realizuar përmes vijës kufitare Hani i Elezit, të cilat janë në shumën 213,880.40€ dhe nga eksporti po ashtu përmes vijës kufitare Hani i Elezit kemi realizuar shumën prej 4,028.43€. Transporti i brendshëm kryesisht është realizuar për "NewCo Ferronikeli" dhe atë në transportin e xehes nga Medveci dhe thëngjillit nga Kastrioti. Në këtë periudhë nga ky lloj i transportit është realizuar shuma prej 343,269.37€.

Transporti i udhëtarëve për periudhën janar – dhjetor 2018, është realizuar në shumën prej 1,769,579.97 €. Nga të hyrat e faturuara nga Transporti i Kontraktuar janë 1,170,612.35 €, nga të hyrat e planifikuara nga subvencioni për mbulimin e pjesshëm të humbjeve nga trenat tjerë të udhëtarëve kemi realizuar shumën prej 500,000.00€. Burimi i të ardhurave nga biletat është realizuar në shumën prej 98,967.62 €, shprehur në përqindje më realizimin e të hyrave nga transporti i udhëtarëve kemi arritur shumën e realizimit 90.02%, krahasuar me planifikimet e vitit 2018 – 1,965,700.00 €.

Të hyrat nga shërbimet tjera gjatë periudhës janar - dhjetor 2018, kanë arritur shumën prej 23,560.91€. Kjo shumë nëse krahasohet me shumën e buxhetuar për vitin 2018 e cila është 50,000.00€ arrin kuotën prej 47.12%. Kjo e hyrë është realizuar në pozicionin të hyrat nga RIV-i dhe vendosjet –23,560.91€.

Të hyra tjera të cilat janë realizuar gjatë periudhës janar – dhjetor 2018, kanë arritur shumën prej 104,793.30€. Kjo e hyrë është realizuar në pozicionet siç vijojnë: Të hyrat nga shitja e derivateve për HK-Infrakos Sh. A. – 43,495.30€, te hyrat nga dëmtimi i vagonëve dhe të tjera në vlerë prej 41,994.53€, të ardhurat nga zbritjet e marrura 7,005.33€ dhe të hyra tjera 12,298.14€. Buxheti i planifikuar është 90,000.00€, shprehur ne përqindjen 116.44 %.

V. 1. 2. Shpenzimet

Shpenzimet për periudhën janar – dhjetor 2018, ashtu edhe siç janë buxhetuar janë të klasifikuara në kategoritë që pasojnë:

Totali i kostos së shërbimit për periudhën është 962,185.64€ nga 860,000.00€ të planifikuara për vitin 2018 dhe arrijnë kuotën prej 111.88%. Shpenzimet sipas grupimeve në kode të posaçme janë të precizuara në tabelën më poshtë - të hyrat dhe shpenzimet operative për periudhën janar – dhjetor 2018.

Shpenzimet e stafit është kategori tjetër e rëndësishme e cila ka arritur shumën prej 1,701,793.44€, dhe atë në paga dhe kontribute – 1,696.783.67€ dhe sigurimi shëndetësor, trajnime dhe shpenzime tjera – 5,009.77€. Në total nëse e krahasojmë shumën e buxhetuar për vitin 2018 – 1,705,000.00€, në këtë kategori kemi arritur kuotën prej 99.81%.

Totali i shpenzimeve operative kap shumën prej 153,783.33€, kjo shumë është 15.99% nga shuma prej 962,000.00€ e parashikuar vitin 2018. Edhe kjo kategori e shpenzimeve sipas grupimeve në kode të posaçme është e precizuar në tabelën e më poshtme – të hyrat dhe shpenzimet operative për periudhën janar – dhjetor 2018.

Totali i shpenzimeve administrative ka arritur në kuotën prej 61.75%, konkretisht në shumën prej 60,513.91€. Planifikimi për vitin 2018, i kësaj kategorie është 98,000.00€. Shpenzimet sipas grupimeve në kode të posaçme janë të precizuara në tabelën e mëposhtme – të hyrat dhe shpenzimet operative për periudhën janar – dhjetor 2018.


TABELA 1. TË HYRAT DHE SHPENZIMET OPERATIVE PËR PERIUDHËN JANAR – DHJETOR 2018

	EMËRTIMI	Realizimi Janar-Dhjetor 2018	Buxheti i Rishikuar 2018	Diferenca	B/C (%)	Realizimi Janar – Dhjetor 2017
	A	B	C	D	E	F
A	Shitjet					
1	Transporti i mallrave	561,178.20	720,332.00	(159,153.80)	77.91	842,834.98
2	TU – Ministria e Infrastrukturës	1,170,612.35	1,316,000.00	(145,387.65)	88.95	1,151,612.81
3	TU – Ministria e Zhvillimit Ekonomik	500,000.00	500,000.00	-	100.00	744,814.73
4	TU – Shitja e Biletave	98,967.62	149,700.00	(50,732.38)	66.11	124,318.57
5	Shërbimet tjera	23,560.91	50,000.00	(26,439.09)	47.12	26,367.95
6	Të ardhurat – Riparimi i vagonëve	38,728.59	40,000.00	(1,271.41)	96.82	17,079.49
7	Të hyrat tjera jo operative	46,761.24	50,000.00	(3,238.76)	93.52	47,905.71
I	TOTAL – TË HYRAT	2,439,808.91	2,826,032.00	(386,223.09)	86.33	2,954,934.24
B	Kostoja e shërbimit/blerjes së materialeve					
1	Derivatet dhe lubrifikantet	464,865.85	360,000.00	104,865.85	129.13	526,400.98


2	Energjia elektrike dhe shërbimet tjera komunale	10,104.37	30,000.00	(19,895.63)	33.68	46,826.48
3	Inventar dhe pajisje	111.53	10,000.00	(9,888.47)	1.12	665.31
4	Material harxhues	198.69	1,000.00	(801.31)	19.87	211.86
5	Pjesë rezervë/mirëmbajtje dhe materiale tjera	23,042.68	35,000.00	(11,957.32)	65.84	32,279.14
6	Qasja në binarë	380,258.50	330,000.00	50,258.50	115.23	509,152.87
7	Sigurimi i palëve të treta	1,977.97	4,000.00	(2,022.03)	49.45	1,627.59
8	Tërheqja e trenave dhe qiraja e vagonëve të huaj	31,778.95	40,000.00	(8,221.05)	79.45	36,497.91
9	Shpenzimet e transportit Infrakos	43,609.00	50,000.00	(6,391.00)	87.22	45,017.59
10	Zbritjet e lejuara	6,238.10	-	6,238.10	0.00	4,850.24
	TOTAL – KOSTOJA E SHERBIMIT	962,185.64	860,000.00	102,185.64	111.88	1,203,529.97
	Fitimi (humbja) bruto	1,477,623.27	1,966,032.00	(488,408.73)	75.16	1,751,404.27
	TE ARDHURAT TJERA					
1	Të ardhurat e jashtëzakonshme	12,298.14	-	12,298.14	0.00	195,904.45
2	Zbritjet e mara	7,005.33	-	7,005.33	0.00	25,959.46
3	Të ardhura tjera	-	800,000.00	(800,000.00)	0.00	72,622.12
	TOTAL – Te ardhurat tjera	19,303.47	800,000.00	(780,696.53)	2.41	294,486.03
C	Shpenzimet e stafit			-		
1	Pagat dhe kontributet	1,696,783.67	1,681,000.00	15,783.67	100.94	1,674,841.09
2	Sigurimi shëndetësor, trajnime dhe shpenzime tjera	5,009.77	24,000.00	(18,990.23)	20.87	30,317.60
	TOTAL - Shpenzimet e stafit	1,701,793.44	1,705,000.00	(3,206.56)	99.81	1,705,158.69
D	Shpenzimet operative			-		
1	Mirëmbajtje dhe riparime	31,124.45	805,000.00	(773,875.55)	3.87	27,704.06
2	Sigurimi fizik – total	34,124.79	52,000.00	(17,875.21)	65.62	33,121.91
3	Shërbimet tjera	-	-	-	0.00	85.79
4	Shpenzimet logjistike	21,311.85	10,000.00	11,311.85	213.12	29,833.03
5	Energjia elektrike dhe komunalitë	4,764.74	20,000.00	(15,235.26)	23.82	4,638.26
6	Sigurimi i palëve të treta	2,485.68	4,000.00	(1,514.32)	62.14	2,499.59
7	Marketingu	1,852.54	18,000.00	(16,147.46)	10.29	2,893.02
8	Udhëtimet zyrtare	392.05	2,000.00	(1,607.95)	19.60	21,942.55
9	Telefonat dhe Posta	20,741.15	20,000.00	741.15	103.71	916.14
10	Shërbimet bankare	809.55	1,000.00	(190.45)	80.96	5,915.34
11	Tatimet	33,727.05	20,000.00	13,727.05	168.64	5,617.86
12	Pajisje elektronike	2,449.48	10,000.00	(7,550.52)	24.49	2,831.66
	TOTAL - Shpenzimet operative	153,783.33	962,000.00	(808,216.67)	15.99	137,999.21
E	Shpenzimet administrative			-		
1	Inventar dhe pajisje	337.63	-	337.63	0.00	946.44
2	Konsulenca dhe auditimi i jashtëm	6,439.84	11,000.00	(4,560.16)	58.54	2,542.38
3	Material i zyrës	6,018.70	10,000.00	(3,981.30)	60.19	6,167.98
4	Material sanitar	1,962.84	6,000.00	(4,037.16)	32.71	6,023.14
5	Qiraja për objektet	8,499.22	10,000.00	(1,500.78)	84.99	7,818.55
6	Reprezentacioni dhe bufeja	3,499.90	4,000.00	(500.10)	87.50	4,289.65
7	Shpenzimet gjyqësore dhe ndëshkimet	27,492.17	22,000.00	5,492.17	124.96	13,587.80

8	Shpenzimet logjistike	5,197.68	25,000.00	(19,802.32)	20.79	2,828.58
9	Kontingjente	1,065.93	10,000.00	(8,934.07)	10.66	8,649.60
	TOTAL - shpenzimet administrative	60,513.91	98,000.00	(37,486.09)	61.75	52,854.12
	Provizionet e borxheve të këqija	24,798.00	-	24,798.00	0.00	0.00
II	TOTAL -SHPENZIMET (B+C+D+E)	2,903,074.32	3,625,000.00	(721,925.68)	80.08	3,099,541.99
III	Fitimi (Humbja) para zhvlerësimit	(443,961.94)	1,032.00	(444,993.94)	-43,019.57	149,833.26
	GRANTET	1,007,383.44	986,695.78	20,687.66	102.10	918,968.73
F	Shpenzimet e zhvlerësimit					
1	Shpenzimet e zhvlerësimit që janë rezultat i granteve	1,007,383.44	986,695.78	20,687.66	102.10	918,968.73
2	Shpenzimet e zhvlerësimit që janë nga buxheti i kompanisë	24,616.56	24,588.12	28.44	100.12	24,335.93
	TOTAL - shpenzime e zhvlerësimit	1,032,000.00	1,011,283.90	20,716.10	102.05	943,304.66
G	Fitimi (humbja) nga veprimtaria	(468,578.50)	(23,556.12)	(445,022.38)	1989.20	125,497.33

Diagrami 1 – Pjesëmarrja e të hyrave sipas llojit të shërbimit për vitin 2018



Diagrami 2 – Pjesëmarrja e shpenzimeve sipas kategorive për vitin 2018



V. 2. Gjendja në para të gatshme – raporti sipas bankës (31.12.2018)

Nr	EMËRTIMI	Saldo 31-12-2018
1	PCB nr. 1114-004229-0001-59	231.00
2	PCB (KTh) nr. 1114-004229-0101-50	0.00
3	BKK - PCB (K) nr. 1114-004229-0201-41	54,554.75
4	BKK - PCB (S) nr. 1114-004229-0301-32	0.46
5	BKK - PCB (M) nr. 1114-004229-0401-23	0.38
6	GH-PCB nr. 1114004229040114	0.00
7	BPB	18.96
	Totali	**54,805.55**

Tabela 5.2.1

V. 3. Bilanci i gjendjes

BILANCI I GJENDJES		
NP TRAINKOS SH.A	**GJENDJA FILLESTARE 01/01/18**	**GJENDJA PERFU. 31/12/18**
Mjetet themelore - vlera neto sipas librave	**6,108,771.81**	**5,499,885.37**
Mjetet Qarkulluese	**3,134,002.69**	**2,829,490.16**
Stoqet	456,130.14	436,801.11
Paraja	695,291.02	54,938.35
Llogarite e arkëtueshme	1,329,086.89	1,872,831.23
Kërkesa tjera të arkëtueshme	382,840.78	440,125.98
Parapagimet	270,653.86	24,793.49
Total Mjetet Qarkulluese dhe themelore	**9,242,774.50**	**8,329,532.58**
Detyrimet afatshkurta	**1,547,353.33**	**1,899,132.83**
Llogaritë e pagueshme	1,318,188.20	1,550,106.50
Të pagueshme tjera - detyrime	3,953.50	3,140.61
Detyrime tatimore	225,211.63	345,885.71
Llogaritë tjera		
Detyrimet afatgjata	**3,933,998.90**	**3,186,968.59**
Kapitali	**5,357,261.52**	**5,307,691.64**
Fitimi/Humbja e bartur	-1,102,387.00	-1,595,839.02
Fitim/ Humbja e vitit	-493,452.02	-468,578.50
Total detyrimet dhe kapitali	**9,242,774.50**	**8,329,532.58**

Tabela 5.3.1

VI. PROJEKTET KAPITALE TË HK - TRAINKOS SH. A.

Gjatë vitit 2018 janë realizuar gjithsej 4 projekte kapitale me vlera të ndryshme kontraktuale. Disa prej këtyre projekteve janë bartur nga vitet paraprake dhe disa tjera janë zhvilluar dhe kanë përfunduar në vitin 2018.

Vlera e përgjithshme e këtyre projekteve arrin shumën prej 360,497.00 €.

Nga projektet kapitale të cilat janë ende në zbatim, për vitin 2018 dhe bartur në vitin 2019 është ”Riparimi i tornos për gdhendjen e rrotave”, projekt ky që pritet të përfundohet gjatë vitit 2019.

Nr	Titulli i Aktivitetit te Prokurimit	Kontraktuar	Buxheti i zotuar	Vlera e kontrates	Koment
1	Furnizimi me regjistrues të shpejtësisë	Mars	25,000.00	23,290.00 €	Në vazhdim
2	Furnizim me naftë për nevojat e Trainkos Sh. A.	Mars	1,400,000.00	240,960.00 €	Përfunduar
3	Furnizimi me material hixhienik	Mars	5,500.00	4,663.80 €	Në vazhdim
4	Furnizim me material administrativ	Mars	5,500.00	5,048.10 €	Në vazhdim
5	Furnizimi dhe montimi i dizel motorit të gjeneratorit 55kw	Mars	4,000.00	3,950.00 €	Përfunduar
6	Renovimi i objektit te tërheqjes së trenave	Tetor 2017	200.000,00	180,414.00 €	Përfunduar
7	Mbikëqyrja e projektit "Renovimi i objektit te tërheqjes së trenave"	Tetor 2017	4,000.00	950.00 €	Përfunduar
8	Shërbimet e sigurimit te palëve të treta	Shkurt	2,000.00	1,685.00 €	Përfunduar
9	Furnizimi me tonera	Shkurt	5,000.00	4,224.50 €	Në vazhdim
10	Riparimi i lokomotivës manovruese	Gusht	20,000.00	16,500.00 €	Përfunduar
11	Riparimi dhe atestimi i vinçave të trenit ndihmës	Shtator	16,000.00	15,360.00 €	Përfunduar
12	Shërbimet e sigurimit të automjeteve	Mars	2,000.00	1,607.61	Në vazhdim
13	Furnizimi me rollne për arkat fiskale të llojit DP 05	Qershor	3,000.00	2,238.00 €	Përfunduar
14	Furnizimi me vajra dhe lubrifikante	Dhjetor	70,000.00	67,601.00 €	Në vazhdim
15	Furnizimi dhe montimi i vinçave dhe mjeteve tjera	Shtator	110,000.00	121,634.40 €	Përfunduar
16	Shërbim konsulence për matjen e kënaqshmërisë së klientëve – Trainkos Sh.A.	Shtator	2,000.00	1,198.50 €	Në vazhdim
17	Riparimi i tornos për gdhendjen e rrotave te mjeteve lëvizëse	Gusht	44,000.00	41,949.50 €	Në vazhdim
18	Furnizimi me pjesë për vetura	Korrik	6,003.00	4,318.00 €	Në vazhdim
19	Furnizimi me papuçe frenuese	Gusht	8,000.00	9,005.76 €	Përfunduar
20	Furnizimi me antifriz	Shtator	3,000.00	2,800.00 €	Përfunduar
21	Kontrollimet sistematike shëndetësore	Mars	12,000.00	12,000.00 €	Në vazhdim
22	Furnizimi me materiale të ndryshme me procedurë minimale	Janar - Dhjetor	24,000.00	23,888.00	Përfunduar
23	Furnizimi me pjesë për lokomotivën 2710 009	Shtator	2,550.00	2,444.44 €	Në vazhdim

Tabela 6.1

VII. PRESPEKTIVA PËR VITIN E ARDHSHËM

Perspektiva për vitin 2019 është e lidhur ngushtë me objektivat ekonomike të diskutuara dhe precizuara në Planin e Biznesit për vitin e ardhshëm të paraqitura më poshtë.

- Ngritja e vazhdueshme profesionale e kapaciteteve të resurseve njerëzore;
- Ngritja e nivelit të bashkëpunimit të qëndrueshëm me partnerët/operatorët rajonal dhe të vendeve të BE-së në transportin hekurudhor;
- Rritja e cilësisë dhe kualitetit të shërbimit në transportin hekurudhor, për një zhvillim të qëndrueshëm të ndërmarrjes;
- Gjetja e modeleve për financimin e pasurimit/rritjes së parkut të mjeteve lëvizëse sipas strategjisë zhvillimore të kompanisë krahas reformave në sektorin hekurudhor;
- Realizimi i të hyrave në bazë të parametrave të projektuar në Planin e Biznesit 2019 për transportin hekurudhor;
- Angazhimi i vazhdueshëm në shfrytëzimin e të gjitha mundësive për përvetësimin e transportit të mundshëm të mallrave brenda dhe jashtë vendit;
- Aktiviteti në mirëmbajtjen e mjeteve lëvizëse në vitin 2019 do të karakterizohet me angazhimin e përhershëm në avancimin e proceseve në mirëmbajtjen e mjeteve lëvizëse dhe ndërmarrja e hapave të nevojshëm për certifikimin e punëtorive sipas kritereve të parapara me ERA[1];
- Krijimi i kushteve më të mira për punë që mundëson ngritjen e sigurisë në komunikacionin hekurudhor;
- Zbatimi i Rregullores për transportin e mallrave dhe hulumtimi i tregut që i përket transportit hekurudhorë me një çmim konkurrues.

VII. 1. SFIDAT DHE RREZIQET E SË ARDHMES SË NDËRMARRJES

Gjatë vitit 2018 si edhe viteve tjera kompania ka vazhduar të ballafaqohet me shumë sfida si në vijim:

1. Mungesa e ligjit për sigurinë në komunikacionin hekurudhor;
2. Proceset e shumta gjyqësore të trashëguara nga ish-Hekurudhat e Kosovës;
3. Mos funksionimi i të gjitha linjave hekurudhore;
5. Vonesat në realizimin e projektit "Modernizimi i Linjës së 10-të hekurudhore" si infrastrukturë bazë që bën lidhjen me pjesën tjetër të Evropës (infrastrukturë dhe reforma të sektorit hekurudhorë);
6. Mos zbatimi i bazës ligjore në sektorin e transportit dhe lejimi i konkurrencës jo lojale;
7. Licencimi dhe futja në treg e operatorit hekurudhor privat, pa ndonjë analizë të mirëfilltë të tregut nga ana e institucioneve relevante;
8. Gjendja jo e mirë e mjeteve lëvizëse për shkak të vjetërisë së tyre dhe kostoja e lartë investuese;
9. Mungesa e një "Master Plani afatmesëm" për TRAINKOS-in;
10. Neglizhenca e institucioneve relevante të cilat veprojnë në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës në inkorporimin e operatorit shtetëror në planifikimet strategjike për zhvillim industrial të vendit;
11. Mos funksionimi normal (sipas planifikimeve) i klientit kryesor në transportin e mallrave;
12. Mosha mesatare e lartë e personelit ekzekutiv;

Duke pasur parasysh që sfidat e lartcekura janë të natyrave të ndryshme dhe kërkojnë përkrahje edhe nga shumë institucione relevante, kompania është munduar në vazhdimësi që këto sfida/probleme t'i paraqes dhe të kërkojë zgjidhje/mbështetje, mirëpo marr parasysh karakterin e tyre ka qenë e pamundur arritja e rezultateve pozitive duke rezultuar edhe me mos përmirësimin e përgjithshëm të kompanisë.


Në vazhdim, mbesim të përkushtuar dhe angazhuar që të gjitha këto probleme të trajtohen nga institucionet dhe faktorët tjerë relevant në mënyrë që të marrim zgjidhjen e duhur, me qëllim të zhvillimit të ndërmarrjes si aset shtetëror.

Angazhimi ynë do të jetë maksimal në arritjen e qëllimeve dhe objektivave të Hekurudhave të Kosovës - TRAINKOS Sh. A.

VIII. STRUKTURA ORGANIZATIVE E TRAINKOS SH. A.

Operimi me trena në Hekurudhat e Kosovës - Trainkos Sh.A, vitin 2018 e ka filluar me një strukturë më të konsoliduar se në vitin 2017. Potenciali njerëzor i punonjësve në fillim të vitit 2018, ka qenë i sistemuar në bazë të përgatitjes së tyre dhe nevojave që ka kërkuar vetë procesi i punës. Shpërndarjes dhe sistemimit të tyre i ka paraprirë skema organizative e kompanisë e cila është ndërtuar në bazë të nevojave të punës të cilën do ta paraqesim në vijim:

Skema organizative e HK-Trainkos Sh. A.



Paraqitja statistikore për llojet e kontratave, mosha e të punësuarve, struktura gjinore, struktura nacionale dhe kualifikimi shkollor i të punësuarve në HK – Trainkos SH.A. është si vijon:

Struktura e të punësuarve në bazë të kategorizimeve të HK-Trainkos Sh.a. më 1 janar 2018 dhe më 31 dhjetor 2018					
Totali i të punësuarve	01.01.2018		31.12.2018		
	233		236		
Vlerat	Vlerat në numra		Vlerat në përqindje		
Data	01.01.2018	31.12.2018	01.01.2018	31.12.2018	
Mosha mesatare e punëtorëve	46.70	46.16	%	%	
Me marrëdhënie të rregullt pune	233	236	%	%	Format e kontratave
Me kontratë të paafatizuar	105	94	45.06%	39.83 %	
Me kontratë të afatizuar	128	142	54.93 %	60.16%	
Meshkuj	209	211	89.69 %	89.40 %	Gjinia
Femra	24	25	10.30 %	10.59%	
Serbë	2	2	0.85 %	0.84 %	Nacionaliteti.
Shqiptarë	231	234	99.14 %	99.15 %	
Me shkollim fillor	16	16	6.86 %	6.77 %	Shkollimi
Shkollim të mesëm	127	127	54.50 %	5.81 %	
Kualifikim profesional	24	28	10.30 %	11.86 %	
Me shkollim të lartë	4	4	1.71 %	1.69 %	
Me shkollim superior	62	61	26.60 %	25.84 %	
Zyrtarët e Lartë	4	4	1.71 %	1.69 %	
Departamenti i Operimeve	140	/////	60.08 %	/////	Përshkrimi i Departamenteve
Kabineti i Kryeshefit Ekzekutiv	3	3	1.28 %	1.27 %	
Departamenti i Transportit të Mallrave	/////	52	/////	22.03 %	
Departamenti i Transportit të Udhëtarëve	/////	63	/////	26.69 %	
Departamenti i Administratës	39	42	16.73 %	17.79 %	
Departamenti i Financave	9	9	3.86 %	3.81 %	
Departamenti i Zhvillimit të Biznesit	7	7	3.00%	2.96 %	
Departamenti i Prokurimit	4	4	1.71%	1.69%	
Zyra e Kontrollit, Sigurisë dhe Kualitetit	20	20	8.58 %	8.47 %	
Zyra për Marrëdhënie me Publikun	3	2	1.28 %	0.84 %	
Zyra e Mirëmbajtjes së Lokomotivave dhe Trenave Motorikë	/////	27	/////	11.44 %	
Zyra Ligjore	4	3	1.71 %	1.27 %	

Tabela 8.1

Sqarim:

Gjatë periudhës janar - dhjetor 2018 kemi pasur 9 punësime, 2 pensionime,4 ndërprerje të një anshme të marrëdhënies së punës. Gjatë vitit 2018 kemi pasur 3 punëtorë me kontratë për punë specifike, të cilët nuk janë përfshirë në tabelën më lart. Po ashtu në këtë tabelë nuk janë përfshirë as anëtarët e Bordit të Drejtorëve.

IX. KONTESTET GJYQËSORE

Gjatë vitit 2018, nga zyra ligjore e ndërmarrjes janë marrë të gjitha veprimet e nevojshme për përfaqësim sa më të mirë në çështjet ligjore pranë të gjitha institucioneve të Republikës së Kosovës. Gjatë vitit që lamë pas, pranë gjykatave themelore i kemi mbajtur **31** (**tridhjetë e një**) seanca gjyqësore për proceset në të cilat kemi qenë palë në procedurë qoftë në cilësinë e të paditurës apo të paditëses.

Gjatë vitit që lamë pas ndërmarrja jonë në procedurë ka pasur **69 (gjashtëdhjetë e nëntë)** lëndë, prej tyre **15 (pesëmbëdhjetë)** janë pranuar gjatë vitit 2018, ndërsa **12 (dymbëdhjetë)** lëndë kanë përfunduar me vendime të formës së prerë.

Prej **12 (dymbëdhjetë)** lëndëve të përfunduara gjatë vitit 2018 me vendime të formës së prerë ndërmarrja jonë është obliguar që të paguajë rreth **173.957,38** € në emër të kompensimeve

Përkundër faktit se Ndërmarrja në vazhdimësi është ballafaquar me probleme të natyrave të ndryshme rreth ruajtjes së interesave të saj e sidomos sa i përket çështjeve që kanë të bëjnë me kontestet nga kompensimi i dëmeve në të gjitha rastet e aksidenteve të komunikacionit hekurudhor prej të cilave konteste një numër i konsiderueshëm janë trashëguar nga ish - Hekurudhat e Kosovës Sh.A., në një mënyre ndërmarrja jonë ka arritur që një situatë të tillë ta menaxhojë me sukses.

IX. RREZIQET NGA KONTESTET GJYQËSORE PËR VITIN 2019

Hekurudhat e Kosovës Trainkos Sh.A. në vitin 2019 pritet të ballafaqohen me **69 (gjashtëdhjetë e nëntë)** konteste gjyqësore.

Në tabelën më poshtë është pasqyruar numri i kontesteve të hapura dhe kategorizimi i tyre për të cilat mund të përfundohen gjatë vitit 2019:

Nr.	LLOJET E KONTESTEVE	Gjithsej
1.	**Kontestet e marrëdhënies së punës**	**14**
2.	**Kontestet për kompensim të dëmit**	**32**
3.	**Kontestet për pagimin e borxhit**	**6**
4.	**Kontest nga Konflikti Administrativ**	**1**
5.	**Lëndë në procedurë përmbarimore**	**16**
6.	**Totali**	**69**

Tabela 9.1

Pra, siç shihet në tabelë, **14 (katërmbëdhjetë)** lëndë janë nga kontestet e punës, **32 (tridhjetë e dy)** lëndë janë nga kontestet e kompensimit të dëmit, **6 (gjashtë)** lëndë janë nga kontestet

për kthim të borxhit, **1 (një)** lëndë nga kontesti i Konfliktit Administrativ dhe **16 (gjashtëmbëdhjetë)** lëndë nga procedura përmbarimore.

Duhet cekur se gjatë viti që lamë pas në Gjykatat e Republikës së Kosovës, kemi mbajtur **30 (tridhjetë)** seanca gjyqësore,me ç'rast janë përfunduar **12 (dymbëdhjetë)** lëndë me vendime të formës së prerë.

Në rast se ndodh që të gjitha këto konteste të përfundohen me vendime të formës së prerë atëherë HK-Trainkos Sh. A rrezikohet që të paguajë në emër të kompensimeve shumën **1.818.610,00 €**, ku duke pas parasysh gjendjen në të cilën gjendet ndërmarrja do të jetë e pa përballueshme.

Vlen të përmendet se rreziku kryesor për HK-Trainkos Sh.A. vjen nga lënda me numër P.nr.173/17, në të cilin rast HK - Infrakos Sh.A. ka parashtruar propozim për përmbarim pranë përmbaruesit privat ku ka kërkuar që HK-Trainkos Sh.A ti përmbarohen në mënyrë të dhunshme shuma në vlerë prej **827.259,27 €.**

Andaj duke pas parasysh gjendjen në të cilën gjendet ndërmarrja jonë, kontestet gjyqësore mbesin si një ndër rreziqet më të mëdha për arsye se janë në numër shumë të madh si dhe me vlera të larta financiare. Në rast të humbjes të ndonjë kontesti kompanisë do ti thellohet kriza financiare edhe më tepër.

X. TRANSAKSIONET E REALIZUARA

Në tabelat në vijim janë paraqitur transaksionet e kompanisë në llogaritë rrjedhëse dhe ato në projektet kapitale të financuara nga Buxheti i Kosovës:

Transaksionet e kompanisë në llogaritë rrjedhëse	
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 01.01.2018	10,106.77
Inkasimet e pranuara gjatë muajve janar – dhjetor 2018	1,190,216.39
Pagesat e kryera gjatë muajve janar – dhjetor 2018	1,200,092.18
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 31.12.2018	231.00

Tabela 10.1

Transaksionet në projektet kapitale të financuara nga Buxheti i Kosovës	
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 01.01.2018	442,211.16
Inkasimet e pranuara gjatë muajve janar – dhjetor 2018	336,104.68
Pagesat e kryera gjatë muajve janar – dhjetor 2018	723,760.09
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 31.12.2018	54,554.75

Tabela 10.2

XI. PËRFUNDIM

Trainkos Sh.A gjatë vitit 2018 është përpjekur maksimalisht në përmbushjen e objektivave të paraqitura në planin e biznesit dhe në përmirësimin e gjendjes jo të mirë ekzistuese. Këtë vit kemi arritur që të përmbushim disa prej objektivave në transportin e mallrave, në veçanti pas rikthimit të transportit vendor dhe ndërkombëtar për kompaninë NewCo Ferronikel, si njëri prej klientëve tonë kryesor dhe strategjik.
Sfidë në vete vazhdon të mbetet transporti ndërkombëtar i mallrave (eksport-import) ku edhe përkundër ndryshimeve të bëra në rregulloren e transportit duke ofruar çmime më të volitshme dhe shërbime më cilësore vazhdon të mbetet në nivele jo të kënaqshme. Duke pasur parasysh që kësaj gjendje i paraprijnë shumë faktorë të jashtëm është e vështirë për t'i evituar. Mbetemi me shpresë në përkrahjen institucionale që kontribuon në hartimin e politikave strategjike të cilat do të nxisnin rritjen transportit të mallrave të transportuara përmes hekurudhës, gjithashtu faktor tjetër shumë i rëndësishëm që duhet cekur është edhe pamundësia e operimit në drejtim të Serbisë, si segment shumë i rëndësishëm për qasje më të lehtë dhe më të shpejt në shtetet evropiane, faktor i cili ka ndikuar drejtpërdrejt në krijimin e kësaj situate.

Për krahasim nga vitet e kaluara për transportin e udhëtarëve (edhe pse me një vonesë prej disa muajve dhe me një numër të trenave të reduktuar), gjatë këtij viti kemi arritur nënshkrimin e marrëveshjes me Ministrinë e Infrastrukturës për OShP me kohëzgjatje prej 5 (pesë) viteve për mbulimin e shpenzimeve të transportit të udhëtarëve nga ana e Qeverisë së Kosovës.

Duke pasur parasysh se transporti hekurudhor është një shtyllë e rëndësishme e zhvillimit industrial dhe ekonomik të vendit, besojmë se qeveria e Kosovës duhet ta vë në prioritet investimin në këtë sektor duke siguruar qëndrueshmëri për operatorin HK-Trainkos Sh.A.

Planifikimet strategjike për sektorin hekurudhor kanë lënë të padefinuar problematikën e mirëmbajtjes së mjeteve lëvizëse hekurudhore për të cilën duhet të punohet me precizitet në proceset e hartimit të një Plani të Biznesit tre apo pesë vjeçar për Trainkos-in. Kjo nëse kemi parasysh planifikimet e Qeverisë të precizuara në "Strategjia Sektoriale dhe Transporti Multimodal 2015–2025 dhe Plani i veprimit 5 vjeçar" për ofrimin e mundësisë së modernizmit të flotës së mjeteve lëvizëse sipas proceseve tjera reformuese në sektorin hekurudhor. Sfidë tjetër në këtë proces është edhe angazhimi në ngritjen e nivelit profesional të stafit dhe kapaciteteve sipas standardeve të kërkuara.

Mbesim të përkushtuar maksimalisht në angazhimet tona të përditshme për zhvillimin e mëtutjeshëm të ndërmarrjes dhe ofrimin e shërbimeve sa më të mira për klientët tanë si në Transportin e Mallrave ashtu edhe në Transportin e Udhëtarëve.

Fushë Kosovë,
28.02.2019

Kryeshef Ekzekutiv
Gelor Shala